



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr 3121/1 prot.

Tiranë më 15.12.2025

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË MJEDISIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka marrë në shqyrtim shkresën tuaj me nr.1486 prot., datë 03.12.2025, administruar me tonën nr.3132 prot., datë 05.12.2025, me anë të së cilës dërgohet për mendim projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e regjistrit elektronik për gazet serrë të fluoruara, produktet dhe pajisjet të cilat regjistrohen, detyrimet e sipërmarrësve për të raportuar si dhe niveli i aksesueshmërisë së regjistrit” i shoqëruar me relacionin shpjegues dhe me Shtojcën I dhe Shtojcën II të tij.

Referuar përmbajtjes së projektvendimit, vërejmë se në germën d) të pikës 3.2, të Kreut II të projektvendimit si pjesë e “të dhënave dytësore që merren nga një bazë tjetër të dhënash” parashikohet aksesimi në të dhënat e gjeneraliteteve në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Mënyra e përpunimit të të dhënave personale të gjendjes civile, aksesimi në këto të dhëna, si dhe mënyra e ndërveprimit të databazave të tjera me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile gëzojnë një rregullim të posaçëm ligjor, konkretisht bazuar në pikat 2, 2/1 dhe 3, të nenit 3, të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar.

Në këtë kontekst, detyrimet që burojnë nga dispozitat e mësipërme ligjore, janë zbërthyer me Udhëzimin e përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për sa më lart, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në cilësinë e kontrolluesit, në zbatim të pikës 12, të Udhëzimit të përbashkët nr. 463/2020, duhet të ndërmarrë masa për paraqitjen e kërkesës për përfshirjen e institucionit në Aneksin 1 (*Lista e institucioneve që marrin informacion, baza ligjore përkatëse, lloji dhe sasia e informacionit që jep shërbimi i*

gjendjes civile dhe mënyra e vënies në dispozicion të këtij informacioni) të këtij Udhëzimi.

Ritheksojmë që ky është një detyrim që buron nga ligji i posaçëm nr.10129/2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar, dhe legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat parashikojnë dispozita konkrete dhe specifike, në kuadër të këtij procesi përpunimi të të dhënave personale dhe ndërveprimi i databazave me shërbimin e gjendjes civile, të cilat duhen respektuar nga çdo kontrollues.

Ndërkohë sa i përket pikës 4, të Kreut II të projektvendimit vërejmë se janë parashikuar rregulla mbi detyrimet e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në këtë kuadër, me respektimin e detyrimeve të sipërpërmendura Zyra e Komisionerit shprehet dakord me këtë projektvendim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi